



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 391/3 Prot.

Tiranë, më 23.02.2026

V E N D I M

Nr. 19 dt. 23.02.2026

“PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË
KËSHILLIT TË ETIKËS DHE KODIT TË ETIKËS TË UNIVERSITETIT TË
SPORTEVE TË TIRANËS”

Mbështetur në nenin 3, pika 4 gërma a), nenin 38 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin nr.57, datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7 pika 4, gërma a), nenin 20 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, në nenin 7 dhe 91 të Rregullores së UST-së, në shkresat e Këshillit të Etikës me nr. 2608/3 Prot., datë 29.10.2025 “Përcjellje e relacionit dhe Draft-Rregullores së Këshillit të Etikës së Universitetit të Sporteve të Tiranës” dhe shkresën nr.120/3 prot., datë 15.01.2026 “Përcjellje e Relacionit dhe Draft-Kodit të Etikës së Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 23.02.2026,


V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores së Organizimit dhe Funkcionimit të Këshillit të Etikës dhe Kodin e Etikës të Universitetit të Sporteve të Tiranës (bashkëlidhur vendimit).
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja e Këshillit të Etikës të Universitetit të Sporteve të Tiranës, miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr.57 , datë 15.12.2020.
3. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim të gjitha njësisve përbërëse të UST-së dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA





UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

KODI I ETIKËS
I
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

Miratuar me Vendimin e Senatit Akademik Nr. 19, date 23.02.2026

KREU I

PARIME TË PËRGJITHSHME DHE VLERAT ETIKE TË UNIVERSITETIT

Neni 1

Baza ligjore

Ky Kod hartohet në mbështetje të dispozitave të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Statutit dhe Rregulloreve të brendshme të Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST), si dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë çështjet e etikës në procesin mësimor, kërkimor-shkencor dhe në veprimtaritë e tjera institucionale.

Neni 2

Qëllimi i Kodit të Etikës

Ky Kod ka për qëllim të përcaktojë një kuadër normativ dhe moral për çështjet që lidhen me etikën në veprimtarinë akademike, kërkimore, sportive dhe institucionale në Universitetin e Sporteve të Tiranës (UST).

1. Ky Kod synon të:

- a. vendosë rregulla të qarta të sjelljes, përgjegjësiive ligjore, profesionale dhe morale për autoritetet drejtuese të UST-së, personelin akademik dhe joakademik, si dhe për studentët, në përputhje me standardet bashkëkohore të etikës akademike, sportive dhe profesionale, duke respektuar lirinë akademike dhe vlerat institucionale;
- b. garantojë integritetin në kërkimin shkencor, duke ruajtur, mbrojtur dhe promovuar profesionalizmin dhe ndershmërinë institucionale e morale të veprimtarisë kërkimore dhe shkencore në UST, në përputhje me parimet ndërkombëtare të etikës në kërkim.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Kodi i Etikës zbatohet në të gjitha fushat e veprimtarisë së Universitetit të Sporteve të Tiranës.
2. Kodi i Etikës është i detyrueshëm për të gjithë personelin akademik, kërkimor-shkencor, ndihmësakademik, administrativ si dhe për studentët e UST-së, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
3. Ky Kod prevalon ndaj çdo rregulloreje tjetër të brendshme, për aq sa ajo rregullon çështje të etikës në veprimtarinë institucionale, mësimore dhe kërkimore të UST-së.

Neni 4

Përkufizime

Në kuptim të këtij Kodi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Integritet”**, nënkupton ndershmërinë, korrektësinë, drejtësinë dhe besnikërinë në ushtrimin e detyrës dhe në përfaqësimin e institucionit.
2. **“Bashkëautorësia”**, nënkupton realizimin e një punimi kërkimor apo akademik nga më shumë se një autor, me kontribute të qarta dhe të ndershme për secilin pjesëmarrës.
3. **“Fabrikimi”**, nënkupton manipulimin e të dhënave ose të rezultateve dhe regjistrimi a publikimi i tyre, si të vërteta.
4. **“Falsifikimi”**, është manipulimi i materialeve kërkimore, pajisjeve, imazheve ose proceseve apo ndryshimi, fshirja a retushimi i të dhënave ose rezultateve pa asnjë motiv.
5. **“Plagjiatura”**, është përdorimi i punës ose ideve të dikujt tjetër, pa dhënë asnjë meritë të burimi original.
6. **“Mosraportimi i konfliktit të interesit në veprimtarinë kërkimore-shkencore”**, i cili është mosdeklarimi i konfliktit të interesit apo të konfliktit të mundshëm të interesit, duke ndikuar në besueshmërinë dhe në objektivitetin e kërkimit shkencor.
7. **“Procedurat e kërkimit shkencor”**, përfshijnë formulimin e pyetjeve kërkimore, ngritjen e hipotezave, analizën e të dhënave, formulimin e rekomandimeve, përdorimin e burimeve dhe raportimin e rezultateve të kërkimit.
8. **“Veprimtaria akademike”**, përfshin procesin e mësimdhënies, trajnimit dhe kërkimit shkencor të zhvilluar në institucionet e arsimit të lartë dhe në strukturat kërkimore të lidhura me to.
9. **“Infrastrukturë bazë”**, nënkupton çdo pasuri, pajisje, mjedis apo burim material që shërben për zhvillimin e procesit mësimor, kërkimor dhe sportiv.
10. **“Infrastrukturë ndihmëse”**, përfshin çdo element tjetër mbështetës që përdoret në funksion të zhvillimit të veprimtarive akademike, kërkimore dhe sportive.
11. **“Komunikim Publik”**, nënkupton çdo formë komunikimi të bërë nga institucioni, punonjësit ose përfaqësuesit e tij, e cila është e destinuar për publikun e gjerë ose për një grup të caktuar jashtë institucionit. Ky komunikim përfshin publikimet në media, postimet në rrjete sociale, eventet, konferencat, si dhe çdo informacion tjetër që shpërndahet në emër dhe për llogari të institucionit.

KREU II

ETIKA NË VEPRIMTARINË AKADEMIKE, INSTITUCIONALE DHE STUDENTORE

Neni 5

Liria akademike dhe kërkimore

1. Në Universitetin e Sporteve të Tiranës (UST) garantohet dhe respektohet plotësisht liria akademike dhe kërkimore si një parim themelor i zhvillimit të procesit mësimor, kërkimor dhe sportiv.
2. Veprimtaria akademike dhe ajo kërkimore-shkencore në UST ushtrohen në përputhje me parimin e lirisë akademike dhe kërkimore, duke promovuar pavarësinë intelektuale, shkencore dhe krijuese të personelit akademik, kërkuesve dhe studentëve.
3. Liria akademike dhe kërkimore garantohet përmes së drejtës:
 - a. për të organizuar dhe zhvilluar veprimtaritë e mësimdhënies, kërkimit shkencor, inovacionit dhe krijimtarisë akademike e sportive;
 - b. për të hartuar dhe zhvilluar programe studimi, module, trajnime dhe fusha të reja të kërkimit shkencor në përputhje me nevojat e zhvillimit të arsimit të lartë dhe të sportit;
 - c. për të organizuar dhe zhvilluar proceset e vlerësimit, avancimit dhe promovimit të personelit akademik, bazuar në meritë, transparencë dhe standarde të përcaktuara.
4. Veprimtaria akademike dhe kërkimore në UST zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, e lirë nga çdo ndikim politik, ideologjik, ekonomik, teknologjik apo ndërhyrje të tjera të jashtme që mund të çenojnë objektivitetin, besueshmërinë ose rezultatet e kërkimit shkencor.

Neni 6

Përgjegjshmëria dhe integriteti

1. Në Universitetin e Sporteve të Tiranës (UST), çdo veprimtari akademike, kërkimore, sportive apo institucionale ushtrohet mbi bazën e përgjegjshmërisë dhe integritetit profesional.
2. Çdo individ që ushtron veprimtari në kuadër të UST-së duhet të reflektojë standardet më të larta të ndershmërisë, korrektësisë dhe etikës profesionale, duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe normat institucionale për të siguruar një veprimtari transparente, të drejtë dhe të përgjegjshme.
3. Personeli i UST-së, gjatë përmbushjes së detyrave të ngarkuara, është i detyruar të zotërojë dhe të zbatojë me profesionalizëm njohuritë dhe aftësitë e fituara, duke i përdorur ato në mënyrë efektive dhe në shërbim të cilësisë së procesit akademik, kërkimor dhe sportiv.
4. Personeli i UST-së duhet të përmbushë detyrat e tij me kompetencë, paanshmëri dhe përgjegjësi të plotë, duke respektuar standardet më të larta të profesionalizmit dhe etikës, si

dhe duke mbajtur përgjegjësi për cilësinë, saktësinë dhe përmbajtjen e punës dhe materialeve që harton apo administron.

Neni 7

Përfaqësimi i Universitetit të Sporteve të Tiranës në Publik

1. Çdo anëtar i personelit të UST-së, kur merr pjesë në debate, intervista, konferenca apo veprimtari publike që lidhen me punën e tij ose me institucionin, duhet të shprehet në përputhje me misionin, vlerat dhe interesat institucionale të Universitetit të Sporteve të Tiranës, duke ruajtur dinjitetin dhe imazhin e tij publik.
2. Çdo anëtar i personelit të UST-së që do të bëjë publike informacione që lidhen me strategjitë, politikat, vendimarrjet, projektet apo aktivitetet promovuese të universitetit, duhet të njoftojë paraprakisht dhe të marrë miratimin e Rektorit, për të garantuar që komunikimi publik të jetë në përputhje me qëndrimin dhe imazhin zyrtar të institucionit.

Neni 8

Përgjegjësia individuale dhe llogaridhënia

1. Sjellja etike në Universitetin e Sporteve të Tiranës (UST) përbën një përgjegjësi të dyfishtë, individuale dhe kolektive. Çdo anëtar i komunitetit universitar ka detyrimin moral dhe profesional për të respektuar dhe zbatuar parimet e këtij Kodi.
2. Çdo individ që ushtron veprimtari akademike, kërkimore, sportive apo institucionale në UST mban përgjegjësi të plotë për veprimet, vendimet dhe sjelljen e tij gjatë ushtrimit të detyrës, në përputhje me funksionin dhe rolin që kryen brenda institucionit. Individët janë të detyruar të tregojnë gjykim të shëndoshë, ndershmëri dhe profesionalizëm, duke vepruar me integritet në përmbushjen e detyrimeve që u janë ngarkuar.
3. Personeli i UST-së, gjatë ushtrimit të detyrës, duhet të udhëhiqet nga parimet e korrektesisë, ndershmërisë, mirësjelljes, bashkëpunimit, solidaritetit, objektivitetit dhe moralit të lartë profesional, duke kontribuar në ruajtjen e imazhit dhe reputacionit institucional të universitetit.

Neni 9

Mbrojtja e informacionit, konfidencialitetit dhe sigurisë

1. Çdo individ që ushtron veprimtari në UST është i detyruar të respektojë konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të detyrave të tij dhe nuk duhet ta përdorë këtë informacion për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat është destinuar.
2. Çdo individ që ushtron veprimtari në UST duhet të menaxhojë informacionin konfidencial në mënyrë të organizuar dhe të kujdesshme, duke parandaluar çdo shpërndarje të tij, që mund të rrezikojë sigurinë ose integritetin e informacionit.

Neni 10

Përdorimi i përgjegjshëm i fondeve, infrastrukturës bazë dhe ndihmëse

1. Çdo individ që ushtron veprimtari në Universitetin e Sporteve (UST) ka të drejtën të përdorë fondet, infrastrukturën bazë dhe ndihmëse të UST-së gjatë ushtrimit të veprimtarisë, me qëllim kryerjen e detyrave të tij dhe për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
2. Çdo individ që ushtron veprimtari në UST ka detyrimin të përdorë me kujdes fondet, infrastrukturën bazë dhe ndihmëse të UST-së, duke parandaluar dëmtimin, keqpërdorimin ose shfrytëzimin e paautorizuar të tyre gjatë ushtrimit të detyrave të tij.
3. Nuk lejohet që personeli i UST-së, drejtpërdrejt ose tërthortë, të përdorë ose të lejojë përdorimin e fondeve, infrastrukturës bazë dhe ndihmëse të UST-së, si dhe të dokumentacionit zyrtar të institucionit, për qëllime të tjera të ndryshme nga kryerja e detyrave zyrtare.

Neni 11

Shmangia e konfliktit të interesit

Rastet e konfliktit të interesit përcaktohen nga ligji “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe nga Rregullorja përkatëse mbi “Konfliktin e interesit” e miratuar nga Universiteti i Sporteve (UST).

“Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të personelit të UST-së, në të cilën ai ka interesa private, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.

Neni 12

Sjellja dinjitoze personale dhe respektimi i mjedisit të punës

Çdo individ që ushtron veprimtari në Universitetin e Sporteve (UST) duhet të mbajë një sjellje të mirë dhe dinjitoze në të gjitha situatat, me qëllim respektimin e moralit dhe etikës gjatë ushtrimit të detyrave të tij.

Çdo individ që ushtron veprimtari në UST ka detyrimin:

1. Të ruajë një paraqitje serioze para studentëve dhe personave të tjerë gjatë orarit të punës, duke përfshirë veshje dinjitoze dhe përdorimin e një gjuhe të zgjedhur, brenda normave të etikës dhe sjelljes qytetare.
2. Të mos lejojë që marrëdhëniet personale të ndikojnë ose të krijojnë përshtypjen se ndikojnë në marrëdhëniet profesionale.

3. Të mos kërkojë dhe të mos pranojë në asnjë formë privilegji, përfitimi, ndërhyrje, favorizimi, pagese apo dhurimi nga studentët ose persona të tjerë, që kanë për qëllim ndikimin në rezultate, vendime ose përfitime të tjera lidhur me detyrën.
4. Të mos bëjë dallime mes studentëve, vartësve apo kolegëve për shkak të njohjeve apo preferencave personale.
5. Të mos bjerë pre e provokimeve, ngacmimeve apo sulmeve të të gjitha formave nga studentët ose persona të tjerë, që bien në kundërshtim me këtë Kod, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me normat morale.
6. Të trajtojë në mënyrë të barabartë vartësit, kolegët dhe studentët, duke shmangur çdo cënim të dinjitetit, personalitetit dhe mendimeve të tyre profesionale.
7. Të trajtojë kolegët (qoftë ata eprorë, të barabartë apo vartës) me mirësjellje dhe respekt.
8. Të shmangë gjatë punës sjelljet që mund të krijojnë një atmosferë jomiqësore ose frikësuese.
9. Të mos konsumojë pije alkoolike, duhan, cigare elektronike, shisha/nargjile ose lëndë narkotike në mjediset e institucionit.
10. Të respektojë dhe zbatojë me përpikmëri orarin e punës, duke e shfrytëzuar kohën vetëm për kryerjen e detyrave që lidhen me pozicionin e tij.

Neni 13

Parimet e etikës gjatë veprimtarisë akademike

Në Universitetin e Sporteve (UST), veprimtaria akademike ushtrohet në kuadrin e përgjegjësisë pedagogjike dhe shkencore dhe shërben si bazë e vlerësimit të performancës së personelit akademik.

Personeli akademik i UST-së ka detyrimin të:

1. Të promovojë interesat më të mira të UST.
2. Të kontribuojë në përmbushjen e misionit dhe realizimin e vlerave të UST.
3. Të ruajë respektin dhe besimin e publikut ndaj UST dhe integritetit të tij.
4. T'i përmbahet përdorimit të përgjegjshëm të lirisë akademike.
5. Të realizojë me performancë të lartë kërkimin shkencor, mësimdhënien dhe praktikën, përmes leximit, studimit, eksperimentimit, vëzhgimit, shkëmbimit dhe vlerësimit objektiv, duke zgjedhur metoda dhe mënyra efikase, të dobishme, të kuptueshme dhe frytdhënëse për studentët.
6. Brenda kohës efektive të punës, të kryejë detyrat akademike, shkencore ose në mbështetje institucionale ndaj të tretëve, në përputhje me Statutin dhe Rregulloret e UST-së;
7. Të njohë, respektojë, zbatojë dhe veprojë në përputhje me aktet e brendshme të UST-së dhe legjislacionin në fuqi.
8. Të respektojë kohën në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;
9. Të angazhohet në zhvillimin e aftësive profesionale akademike dhe të marrë pjesë në veprimtari formuese për këtë qëllim.

10. Të mos kërkojë ose pranojë asnjë përfitim pasuror për kryerjen e detyrave akademike, përveç pagesës dhe honorareve të përcaktuara me ligj, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme të UST-së.
11. Të mbajë përgjegjësi të plotë për veprimet e tij gjatë kryerjes së detyrës si personel akademik i UST-së.
12. Të zbatojë etikën institucionale në respektim të imazhit të institucionit dhe figurës profesionale.
13. Të ruajë një paraqitje serioze gjatë orarit të punës, që përfshin veshje serioze e dinjitoze, përdorimin e një fjalori të zgjedhur dhe brenda normave të etikës e të sjelljes qytetare.
14. Të respektojë dinjitetin dhe integritetin njerëzor dhe profesional të studentëve dhe të personelit të UST-së.
15. Të mos përdorë auditorin dhe mjediset e tjera të institucionit për veprimtari që nuk lidhen me mësimdhënien apo për të fyer dhe diskriminuar studentët, për të fyer, shpifur apo diskriminuar kolegët dhe autoritetet drejtuese të çdo niveli, për çfarëdo lloj arsyeje apo konflikti.

Personeli akademik i UST-së nuk mund të penalizohet për shkak të opinioneve të tij ndaj politikave të institucionit. Pavarësisht opinioneve personale, personeli akademik vepron gjithmonë brenda normave të etikës, në respekt të institucionit dhe kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.

Neni 14

Parimet e etikës gjatë veprimtarisë ndihmëskadematike dhe administrative

Në Universitetin e Sporteve (UST), veprimtaria e personelit ndihmëskadematik dhe administrativ ushtrohet me integritet, përgjegjshmëri dhe bazuar në ndershmëri.

Personeli ndihmëskadematik dhe administrativ i UST-së ka detyrimin që, brenda kohës efektive të punës, të kryejë detyrat ndihmëskadematike dhe administrative në mënyrë të përpikët, profesionale dhe në përputhje me aktet e brendshme të institucionit dhe legjislacionin në fuqi.

1. Të promovojë interesat më të mira të UST.
2. Të kontribuojë në përmbushjen e misionit dhe realizimin e vlerave të UST.
3. Të ruajë respektin dhe besimin e publikut ndaj UST dhe integritetit të tij.
4. Brenda kohës efektive të punës, të kryejë detyrat ndihmëskadematike dhe administrative, në mbështetje institucionale ndaj të tretëve, në përputhje me Statutin dhe Rregulloret e UST-së;
5. Të njohë, respektojë, zbatojë dhe veprojnë në përputhje me aktet e brendshme të UST-së dhe legjislacionin në fuqi.
6. Të angazhohet në zhvillimin e aftësive profesionale ndihmëskadematike dhe administrative dhe të marrë pjesë në veprimtari formuese për këtë qëllim.

7. Të mos kërkojë ose pranojë asnjë përfitim pasuror për kryerjen e detyrave ndihmëskadematike dhe administrative, përveç pagesës dhe honorareve të përcaktuara me ligj, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme të UST-së.
8. Të mbajë përgjegjësi të plotë për veprimet e tij gjatë kryerjes së detyrës si personel akademik i UST-së.
9. Të zbatojë etikën institucionale në respektim të imazhit të institucionit dhe figurës profesionale.
10. Të ruajë një paraqitje serioze gjatë orarit të punës, që përfshin veshje serioze e dinjitoze, përdorimin e një fjalori të zgjedhur dhe brenda normave të etikës e të sjelljes qytetare.
11. Të respektojë dinjitetin dhe integritetin njerëzor dhe profesional të studentëve dhe të personelit të UST-së.
12. Të mos përdorë auditorin dhe mjediset e tjera të institucionit për veprimtari që nuk lidhen me mësimdhënien apo për të fyer dhe diskriminuar studentët, për të fyer, shpifur apo diskriminuar kolegët dhe autoritetet drejtuese të çdo niveli, për çfarëdo lloj arsyeje apo konflikti.

Personeli ndihmëskadematik dhe administrativ i UST-së nuk mund të penalizohet për shkak të opinioneve të tij ndaj politikave të institucionit. Pavarësisht opinioneve personale, ai vepron gjithmonë brenda normave të etikës, në respekt të institucionit dhe kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.

Neni 15

Parimet e etikës gjatë veprimtarisë studentore

Në Universitetin e Sporteve të Tiranës (UST), veprimtaria studentore ushtrohet me integritet, përgjegjshmëri dhe mbështetur në ndershmëri.

Studentët kanë detyrimin të respektojnë dispozitat e këtij Kodi dhe aktet e brendshme të UST-së gjatë gjithë kohës që gëzojnë statusin e studentit, si dhe të sillen në përputhje me normat etiko-morale.

Studentët mbajnë përgjegjësi të plotë për veprimet e tyre gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve në UST.

Studentët kanë detyrimin që:

1. Të zbatojnë orarin e mësimin dhe të respektojnë rregullat e mësimin, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UST-së.
2. Të paraqiten në mënyrë serioze dhe dinjitoze në mjediset e institucionit, duke përfshirë një veshje të përshtatshme dhe përdorimin e një gjuhe të zgjedhur sipas normave të etikës, moralit dhe mirësjelljes.

3. Të respektojnë dinjitetin dhe integritetin njerëzor dhe profesional të studentëve të tjerë dhe të personelit të UST-së.
4. Të mos kryejnë veprime apo gjeste provokuese ose ngacmuese ndaj personelit të UST-së apo studentëve të tjerë në mjediset e institucionit.
5. Të mos ofrojnë, në asnjë formë dhe për asnjë arsye, privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime apo dhurime, as vetë dhe as përmes personave të tjerë, me qëllim marrjen e rezultateve të larta ose përfitimeve të tjera nga pedagogët për shkak të detyrës së tyre.
6. Të mos kopjojnë, të mos mashtrojnë gjatë procesit mësimor, si dhe të mos shmangen nga shlyerja e detyrimeve mësimore.
7. Të mos konsumojë pije alkoolike, duhan, cigare elektronike, shisha/nargjile ose lëndë narkotike në mjediset e institucionit.
8. Të mos përdorin celular dhe pajisje të tjera elektronike dhe ta mbajnë atë të fikur gjatë orarit të mësimit. Të mos mbajnë dhe përdorin celular gjatë provimit në auditor.
9. Të mbajnë me vete përgjatë provimeve kartën e identitetit ose të studentit dhënë nga UST, dhe ta paraqesin atë sipas një kërkesë të bazuar nga anëtarët e personelit akademik apo administrativ të institucionit.
10. Studenti i cili përfshihet në një veprim të ndaluar apo thyerje të kodit ligjor, i cili rezulton në prishjen e orës së mësimit mund të detyrohet nga pedagogu të lërë auditorin për periudhën e mbetur të orës së mësimit. Për raste të përsëritura duhet të merren vendime me shkrim nga organet përkatëse në përputhje me kuadrin rregullativ të UST-së.

Si anëtarë të UST, studentët gëzojnë të drejtat dhe liritë si vijon:

1. Të përfaqësohen në organet kolegjiale të UST-së, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.
2. Të marrin pjesë në të gjitha proceset e vendimmarrjes së UST-së, në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore.
3. Të ndjekin leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me programin e studimit që ata po ndjekin.
4. Të përdorin në oraret e lejuara mjedise në biblioteka, salla kompjuterash, laboratorë, mjedise sportive dhe shërbime të tjera që ofrohen për studentët nga institucioni.
5. Të shprehin opinionin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të institucionit, nëpërmjet vlerësimeve semestrale ose vjetore që organizohen nga njësitë e sigurimit të cilësisë.
6. Të përfitojnë bursë studimi kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga aktet nënligjore në fuqi, si dhe shpërblime të tjera veçanta që administrohen nga UST.
7. Të pajisen me diplomë, ose certifikatë në përfundim të një programi studimi, si dhe me të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme.
8. Të marrin pjesë në programe studimi jashtë njësisë kryesore ku studiojnë, të zhvillojnë një apo shumë semestra jashtë UST-së, si dhe t'u njihen kreditet dhe lëndët e zhvilluara.

9. Të zhvillojnë praktika mësimore, në institucione që kanë marrëveshje bashkëpunimi me UST-në apo njësitë kryesore.
10. Të pajisen me Kartën e Studentit dhe të përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara.
11. Të organizohen në organizata jofitimprurëse, brenda UST-së, duke iu përmbajtur përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
12. Cdo student ka të drejtën të jetë i lirë nga diskriminimi në përputhje me Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.
13. Studentët kanë të drejtën e lirisë së shprehjes, të mbledhjes dhe grupimeve për aq kohë sa shfrytëzimi i këtyre lirive pajtohet me politikën e institucionit, nuk ndërhyjnë në drejtimin efektiv të jetes universitare dhe respekton të drejtat e të tjerëve.
14. Studentët janë të lirë të organizojnë dhe marrin pjesë në organizata studentore, për të promovuar interesin e tyre të përbashkët brenda institucionit.
 - a. Organizatat studentore janë të lira të shqyrtojnë dhe diskutojnë të gjitha çështjet e interesit, në përputhje me kuadrin legjislativ të UST-së;
 - b. Organizatat e njohura dhe të pranuara mund të gëzojnë privilegjin të përdorin godinat, lehtësirat dhe shërbimet e institucionit sipas politikave dhe procedurave administrative të UST-së.

Neni 16

Llojet e shkeljeve disiplinore për personelin akademik

1. Personeli akademik është përgjegjës për shkeljet e disiplinës në punë dhe të mospërbushjes së detyrimeve të parashikuara në legjislacionin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në Statut dhe rregulloret apo aktet e tjera të Universitetit të Sporteve të Tiranës. Shkeljet disiplinore kategorizohen, si më poshtë, në:

- a) shkelje të rënda;
- b) shkelje të lehta.

2. Konsiderohen shkelje të rënda:

- a) moszbatimi i paarsyeshëm për kryerjen e detyrave të caktuara në bazë të kontratës së punës, mos realizimi në mënyrë të pa justifikuar i procesit akademik;
- b) vjedhja, mashtrimi, falsifikimi, dëmtimi ose shfrytëzimi i paautorizuar i pasurisë së Universitetit;
- c) veprimet në kundërshtim me Kodin e Etikës të Universitetit;
- ç) mungesa e paarsyeshme në punë në mënyrë të përsëritur;

d) gabimet e përsëritura të cilat me shpeshtësinë dhe peshën e tyre çrregullojnë ecurinë normale të punës;

dh) diskriminimi ose keqtrajtimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, ndaj personave të tjerë në Universitet, në bazë gjinore, race, ngjyre, gjuhe, religjioni, besimi, bindjeve politike, origjinës sociale, dhe rasteve të tjera të mbrojtura me ligj;

e) ngacmimi seksual i karakterizuar si çfardo sjellje fizike ose verbale e natyrës seksuale, shkelja e dinjitetit të personit në punë si e pa dëshirueshme ose fyese e cila krijon armiqësi, duke kërcenuar, frikësuar e intimiduar personin;

ë) sjellja e keqe jashtë vendit të punës që nuk përkon me statusin e personelit ose studentit në Universitet, veprim apo mos veprim që diskretiton Universitetin dhe prish apo njollos imazhin e tij;

f) demtimi i pronës me paramendim;

g) zbulimi i fshehtësive afariste;

gj) paaftësi serioze gjatë punës e shkaktuar nga përdorimi i pijeve alkoolike dhe substancave të ndaluara, si dhe përdorimi i tyre në ambjentet e universitetit;

h) dhënia e deklaratave të rreme;

i) email-e ose komunikime të tjera elektronike jo të përshtatshme që përmbajnë kërcënim, fyerje, diskriminime, etj;

j) rryshfeti dhe korrupsioni;

k) sjellje agresive, kërcënuese ose fyese në vendin e punës, dhe shkelje të ngjashme të parapara me Ligj dhe aktet nënligjore në fuqi si edhe ato të universitetit;

l) përvetësimi i pronësisë intelektuale, ku përfshihet plagjiatura gjithashtu.

3. Konsiderohen shkelje të lehta:

a) Mungesa e paarsyeshme në punë deri në 2 (dy) ditë;

b) Shkelje të lehta të ardhura si shkak i pakujdesisë dhe që nuk përbëjnë objekt për të filluar procedim disiplinor, të cilat konsiderohen si shkelje jo me pasojë në thyerje të disiplinës, të kuadrit legjislativ dhe Kodit të Etikes.

Neni 17

Masat disiplinore për personelin akademik

1. Masat disiplinore për personelin akademik janë:

- a) Vërejtje (shkeljet e lehta)
- b) Vërejtje me shkrim (shkeljet e rënda)
- c) Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna (shkeljet e rënda)
- d) Largim ngadetyra (shkeljet e rënda)

2. Masat disiplinore jepen nga autoritetet drejtuese akademike, me përjashtim të largimit nga detyra që është kompetencë vetëm e titullarit të institucionit.

3. Largimi nga detyra i personelit akademik të UST-së bëhet nga titullari i institucionit, me propozimin e Keshillit të Etikes, pas miratimit të komisionit *ad hoc*, të ngritur nga Senati Akademik, në rastet e shkeljeve të rënda dhe të përsëritura të ligjit.

Neni 18

Procedura për dhënien e masave disiplinore

1. Shkeljet e lehta procedohen nga Komisioni disiplinor i njësisë kryesore, i cili përbëhet nga:

- a) Drejtuesi i njësisë kryesore;
- b) Drejtuesi i njësisë bazë ku bën pjesë anëtari i personelit akademik që procedohet;
- c) Njëri nga zëvendësdekanët/zëvendës drejtorët, i cili përcaktohet në fillim të çdo viti nga dekanati/drejtoria e institutit. Kur nuk ka të tillë, përcaktohet një anëtar i njësisë kryesore i kategorisë “Profesor”.

2. Për shkeljet e lehta, Komisioni disiplinor ka të drejtë që të japë masën disiplinore “Vërejtje”.

3. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisionit disiplinor të njësisë kryesore përcaktohen në rregulloret e njësive kryesore.

4. Në rastin kur shkeljet disiplinore verifikohen se janë të rënda, atëherë komisioni disiplinor ku ushtron veprimtarinë e tij personeli akademik, i drejtohet Këshillit të Etikës, së bashku me një relacion, ku shpjegohet shkelja e kryer dhe e shoqëruar me materiale të tjera provuese.

5. Komisioni disiplinor në njësitë kryesore dhe Këshilli i Etikës, kanë të drejtën dhe detyrimin që të kryejnë një hetim të plotë administrativ duke vënë në dispozicion të anëtarit të personelit akademik të gjitha materialet e procedimit, si dhe duke i dhënë atij të drejtën për t'u mbrojtur përmes mundësisë për t'u shprehur me shkrim, si edhe për të zhvilluar seancë dëgjimore me të."

6. Këshilli i Etikës merr në shqyrtim shkeljen duke zhvilluar një hetim administrativ dhe në përfundim të hetimit propozon masën disiplinore të cilën ja përcjell Senatit Akademik. Senati Akademik ngre një komision disiplinor *ad hoc*, të përbërë nga tre anëtarë të përzgjedhur midis anëtarëve të Senatit.

7. Kryetari i komisionit përzgjidhet nga vetë Senati Akademik.

8. Komisioni Disiplinor *ad hoc* i Senatit Akademik ka të drejtë që të marrë këto masa disiplinore:

a) vërejtje me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna

c) në rastet kur shkelja është konsideruar e rëndë dhe e përsëritur, komisioni mund t'i kërkojë Rektorit zgjidhjen e menjehershme të kontratës së punës me anëtarin e personelit akademik dhe largimin e tij nga detyra.

9. Në rast kërkesë nga Komisioni disiplinor *ad hoc* i Senatit Akademik, rektori bën zgjidhjen e kontratës duke respektuar kërkesat e Kodit të Punës.

10. Masa "Vërejtje me shkrim" regjistrohet në dosjen e personelit efektiv. Kjo masë konsiderohet si e padhënë dhe hiqet nga dosja e personelit me kalimin e një afati 6- mujor, kur gjatë të cilit personeli efektiv nuk merr një masë tjetër të njëjtë ose më të rëndë disiplinore.

11. Masa "Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra" në rastet kur brenda një afati 6-mujor personeli ka marrë dy masa "Vërejtje me shkrim". Kjo masë disiplinore regjistrohet në dosjen e personelit dhe i ruan efektet për një periudhë 1-vjeçare.

12. "Zgjidhja e kontratës së punës dhe largimi nga detyra i personelit akademik" kryhet për veprime në kundërshtim flagrant dhe të hapur me kodin e etikës, rregullat e funksionimit të institucionit, ose kur brenda periudhës një vjeçare personeli është në kushtet e marrjes së një mase të dytë "Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra".

Neni 19

Rastet e shkeljeve dhe masat që merren ndaj studentit

1. Shkelje të rregullave të institucionit konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që çënojnë personalitetin e pedagogut apo të çdo punonjësi tjetër të universitetit; normat etiko-morale të shoqërisë, si: kopjimi në provime, falsifikimi i dokumenteve të ndryshme zyrtare, etj; aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes etj.
2. Ndaj studentit që kryen shkelje, mund të merren këto masa disiplinore:
 - a) vërejtje me paralajmërim;
 - b) përjashtim nga universiteti për një vit;
 - c) përjashtim nga universiteti.
3. Shkeljet disiplinore të kryera nga studentët procedohen nga Këshilli i Etikës.
4. Këshilli i Etikës merr në shqyrtim shkeljen duke kryer hetim administrativ dhe në përfundim të hetimit propozon masën disiplinore të cilën ja përcjell për miratim Dekanatit kur propozohet “përjashtim nga universiteti për një vit” dhe Rektoratit kur propozohet “përjashtim nga universiteti”.
5. Vendimi përfundimtar i Këshillit të Etikës “vërejtje me paralajmërim” është i ankimueshëm drejtpërdrejtë në rrugë gjyqësore.

KREU III

ETIKA NË KËRKIMIN SHKENCOR DHE MEKANIZMAT DISIPLINORE

Neni 21

Parimet e etikës gjatë kërkimit shkencor

Parimet themelore të integritetit në kërkimin shkencor orientojnë kërkuesit në punën e tyre dhe angazhimin ndaj sfidave praktike, etike dhe intelektuale që shoqërojnë ose burojnë nga procesi i kërkimit shkencor.

Parimet kryesore të etikës gjatë kërkimit shkencor janë:

1. Garancia për cilësinë e kërkimit.
2. Shmangia e plagjiaturës.
3. Ndershmëria në zhvillimin dhe komunikimin e rezultateve, me transparencë, drejtësi dhe paanshmëri.
4. Respekti ndaj kolegëve.
5. Kujdesi për trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.
6. Përgjegjësia shoqërore për kërkimin shkencor

Neni 22

Mjedisi i kërkimit dhe detyrimet e institucionit ndaj kërkimit

1. Universiteti i Sporteve (UST) promovon dhe mbron kërkimin shkencor, duke siguruar integritetin e veprimtarisë kërkimore-shkencore.
2. Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST) ndjek politika të qarta dhe zbaton procedura institucionale të mbështetura në parimet dhe standardet e përcaktuara në Kodin Europian të Sjelljes për Integritetin në Kërkimin Shkencor, të hartuar nga ALLEA (All European Academies).
3. Të gjitha aktivitetet kërkimore dhe projektet shkencore të UST zhvillohen në përputhje me parimet themelore të *besueshmërisë, ndershmërisë, respektit dhe përgjegjshmërisë*, duke garantuar:
 - a) paraqitje etike të kërkimit;
 - b) zbatim korrekt të aktiviteteve kërkimore;
 - c) menaxhim të përgjegjshëm të të dhënave;
 - d) respektim të autorësisë shkencore;
 - e) shpërndarje të ndershme e transparente të rezultateve.
4. Çdo projekt dhe aktivitet kërkimor i UST-së respekton kuadrin përkatës etik dhe ligjor europian dhe ndërkombëtar, përfshirë Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian dhe Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe garantimin e të drejtave të pjesëmarrësve në kërkim.
5. UST mbështet me infrastrukturën e nevojshme përdorimin dhe mbrojtjen e të dhënave dhe materialeve të kërkimit në të gjitha format e tyre, duke siguruar riprodhueshmërinë, vazhdimësinë e kërkimit dhe përgjegjësinë shoqërore të rezultateve të tij. Kjo përfshin statistikën, informacionet, protokollin, procesin, dokumentet, produktet e tjera kërkimore, si dhe të dhënat shpjeguese përkatëse.
6. UST inkurajon promovimin profesional dhe institucional të kërkuesve, duke mbështetur meritokracinë dhe transparencën në vlerësim dhe avancim.

Neni 23

Sjellja e përgjegjshme në veprimtaritë kërkimore

Në Universitetin e Sporteve të Tiranës (UST), kërkuesit janë të angazhuar në arritjen e standardeve më të larta në kërkimin shkencor, si dhe në ruajtjen e standardeve profesionale.

1. Kërkuesit bëjnë kujdes maksimal për metodat dhe procedurat e analizës, dokumentimit dhe formulimit të rekomandimeve të kërkimit shkencor.
2. Kërkuesit përdorin në mënyrë racionale dhe të përgjegjshme fondet e kërkimit shkencor.
3. Rezultatet, interpretimet, përfundimet dhe rekomandimet e kërkimit shkencor publikohen në mënyrë të qartë, të saktë dhe transparente, duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave ose të gjetjeve, kur kjo është e nevojshme ose kërkohet.
4. Kërkuesit raportojnë rezultatet e kërkimeve sipas standardeve të kërkuara dhe, aty ku është e zbatueshme, në mënyrë që të jenë të verifikueshme dhe të riprodhueshme.

Neni 24

Respekti dhe masat mbrojtëse në kërkimin shkencor

Në Universitetin e Sporteve të Tiranës (UST), kërkuesit veprojnë në përputhje me kodet dhe rregulloret e disiplinave përkatëse të fushave të studimit.

1. Kërkuesit trajtojnë subjektet e kërkimit, që mund të jenë njerëz, kafshë, objekte kulturore, biologjike, mjedisore, fizike ose historike, me kujdes dhe respekt, në përputhje me dispozitat ligjore dhe etike në fuqi.
2. Kërkuesit tregojnë kujdes maksimal për shëndetin, sigurinë, integritetin dhe mirëqenien e komunitetit, bashkëpunëtorëve dhe personave të tjerë që marrin pjesë ose janë të lidhur me kërkimin.
3. Protokollet, metodologjitë dhe teknikat e kërkimit respektojnë ndjeshmëritë që lidhen me diferencat moshe, gjinore, seksuale, kulturore, fetare, etnike, ekonomike, financiare dhe sociale midis komuniteteve, individëve, bashkëpunëtorëve dhe të tjerëve të përfshirë në kërkim.
4. Kërkuesit shmangin çdo rrezik dhe dëm të mundshëm që kërkimi mund të shkaktojë mbi komunitetet, individët, mjedisin, trashëgiminë historike dhe kulturore, si dhe mbi perspektivat e zhvillimit në territorin ku kryhen studimet.

Neni 25

Përdorimi dhe ruajtja e të dhënave kërkimore

1. Në Universitetin e Sporteve të Tiranës (UST), personeli akademik dhe kërkimor siguron që qasja në të dhënat kërkimore të jetë sa më e hapur: e gjatshme, e analizueshme, ndërvepruese, transparente dhe e ripërdorshme. Qasja mund të kufizohet vetëm në masën e nevojshme për të mbrojtur të dhënat sensitive.
2. Personeli akademik dhe kërkimor prodhon të dhëna dhe produkte legjitime, të mundshme për t'u cituar, duke respektuar standardet e citimit dhe normat akademike.
3. Çdo kontratë ose marrëveshje për publikimin ose përdorimin e rezultateve të kërkimit duhet të respektojë pronësinë intelektuale dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit.

Neni 26

Bashkëpunimi dhe komunikimi në kërkimin shkencor

1. Të gjithë bashkëpunëtorët në studimet e përbashkëta bien dakord që në fillim mbi qëllimet e punës kërkimore dhe mbi mënyrën e komunikimit gjatë procesit dhe rezultateve të kërkimit, në mënyrë sa më transparente dhe të hapur.
2. Bashkëpunëtorët bien dakord që në fillim mbi standardet për integritetin e procesit kërkimor, mbi ligjet dhe rregulloret që do të zbatohen, mbi mbrojtjen e të drejtës së autorit për bashkëpunëtorët, si dhe mbi procedurat për trajtimin e mosmarrëveshjeve në rastet e shkeljes së dispozitave të këtij Kodi.
3. Bashkëpunëtorët bien dakord që në fillim mbi vendimin për dërgimin ose jo për botim të rezultateve të kërkimit.
4. Bashkëpunëtorët kanë detyrimin të njohin kontributin e njëri-tjetrit si bashkëautorë në të gjitha fazat e kërkimit, duke përfshirë konceptimin, mbledhjen e të dhënave, analizën dhe interpretimin e rezultateve.
5. Bashkëautorët kanë detyrimin që të sigurojnë që puna e secilit të jetë e arritshme për kolegët në procesin e kërkimit, në mënyrë të hapur, transparente, të saktë dhe në kohën e duhur, përveç rasteve kur përcaktohet dhe vendoset ndryshe.
6. Bashkëautorët kanë detyrimin të bëjnë të njohur çdo konflikt interesi, mbështetje financiare ose mbështetje të ndonjë lloji tjetër për kërkimin dhe/ose për botimin e rezultateve.
7. Bashkëautorët kanë detyrimin të jenë të hapur dhe të ndershëm në komunikimin e rezultateve të kërkimit ndaj publikut dhe mediave. Ata konsiderojnë për botim dhe shpërndarje si rezultatet që provojnë hipotezat e kërkimit, ashtu edhe gjetjet që nuk i provojnë ato.

Neni 27

Shkeljet e integritetit në kërkimin shkencor

Përbëjnë shkelje të etikës çdo shkelje e rëndë e integritetit në kërkimin shkencor, si dhe shkelje të lehta të përsëritura të integritetit shkencor, sipas dispozitave të këtij neni.

Shkeljet e etikës në shkencë dhe në kërkim shkencor

1. Nëse punonjësi kërkimor-shkencor, në ushtrimin e veprimtarisë së tij kërkimore-shkencore cenon integritetin dhe etikën e kërkimit shkencor, duke ndikuar në besueshmërinë e cilësinë e tij, ky cenim konsiderohet si shkelje e etikës në shkencë dhe në kërkim shkencor.

2. Për përcaktimin e masës këshilluese ose disiplinore të zbatueshme, Këshilli i Etikës bazohet në:

- a) shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj;
- b) shkallën e fajësisë;
- c) ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme

3. Shkeljet e etikës në veprimtarinë kërkimore-shkencore janë, si më poshtë vijon:

- a) Fabrikimi
- b) Falsifikimi
- c) Mosraportimi i konfliktit të interesit
- ç) Plagjiatura

4. Parimet për trajtimin e shkeljeve dhe akuzave për sjellje të papranueshme janë, si më poshtë vijon:

- a) Kushdo që akuzohet për shkelje të etikës në shkencë dhe në kërkim shkencor prezumohet i pafajshëm derisa të provohet e kundërta;
- b) Palët e përfshira në hetim deklarojnë çdo konflikt interesi, që mund të lindë gjatë hetimit;
- c) Hetimet kryhen në mënyrë konfidenciale, me qëllim mbrojtjen e palëve në proces;

c) Procedurat e përgjithshme për trajtimin e shkeljeve të praktikës së mirë të kërkimit shkencor janë transparente dhe garantojnë uniformitetin e tyre;

d) Personave të akuzuar për shkelje të etikës në shkencë dhe në kërkim shkencor u garantohet një procesi drejtë administrativ gjatë procesit të hetimit.

Neni 28

Masat këshilluese në Kërkimin Shkencor

1. Masat këshilluese propozohen nga Këshilli i Etikës dhe jepen nga titullari i institutit apo njësisë së veçantë të kërkimit shkencor.

2. Masat këshilluese konsiderohen:

a) “Tërheqja e vëmendjes”, në rastet kur punonjësi kërkimor-shkencor nuk respekton këshillat, rekomandimet ose procedurat e strukturave eprorë;

b) “Tërheqje e vëmendjes dhe paralajmërim për dhënie mase disiplinore”, kur nuk është zbatuar propozimi për ndryshimin e metodologjisë dhe të praktikave të aplikuara përgjatë veprimtarisë kërkimore-shkencore nga punonjësit kërkimorë-shkencorë;

c) “Paralajmërim për pezullim të veprimtarisë kërkimore-shkencore”, në rastin kur duhet të realizohet rihartimi i projektit kërkimor-shkencor, në çdo fazë, nga punonjësi kërkimor-shkencor;

ç) “Vërejtje për shkelje të përsëritur dhe pezullim të veprimtarisë kërkimore-shkencore”, njoftimi për rishikimin dhe ridimensionimin e projektit kërkimor-shkencor nga Këshilli i Etikës.

Neni 29

Shkeljet e etikës

1. Shkeljet e etikës në shkencë dhe në kërkim shkencor të masave këshilluese kategorizohen si:

a) shkelje të lehta, që konsiderohen:

i. mosrespektimi i këshillave ose i rekomandimeve të udhëheqësit shkencor;

ii. mosrespektimi i procedurave etike të vendosura nga strukturat eprorë;

iii. mosrespektimi i metodologjive të kërkimit nga kërkuesit shkencorë;

iv. mosrespektimi i praktikave të mira të kërkimit nga kërkuesit shkencorë.

b) shkelje të rënda, që konsiderohen:

i. mosrespektimi i përsëritur i këshillave ose i rekomandimeve të udhëheqësit shkencor, duke mos rihartuar projektin në çdo fazë;

ii. mosrespektimi i përsëritur i korrigjimit të metodologjive ose praktikave të mira, të kërkimit shkencor, duke rishikuar dhe ridimensionuar projektin kërkimor-shkencor.

c) shkelje shumë të rënda, që konsiderohen:

i. mosrespektimi i çdo parimi dhe kriteri etik të këtij kodi;

ii. mosrespektimi i konfidencialitetit dhe i bërjes publike të materialeve konfidenciale të veprimtarisë kërkimore-shkencore.

Neni 30

Shkeljet disiplinore

1. Shkeljet në shkencë dhe në kërkim shkencor kategorizohen si:

a) shkelje të lehta, që konsiderohen:

i. manipulimi i produktit autorial, të paktën në një rast;

ii. mosdeklarimi i drejtpërdrejtë i faktit të një konflikti interesi të drejtpërdrejtë ose të mundshëm përgjatë procesit kërkimor-shkencor;

b) shkelje të rënda, që konsiderohen:

i. plagjiatura e konstatuar sipas kriterëve në legjislacionin në fuqi;

ii. kompromentimi i etapave të ndryshme të veprimtarisë së kërkimit shkencor;

iii. manipulimi i tërthortë ose i plotë i rezultateve, dokumentacioneve, metodologjive, të dhënave, që mundësojnë rezultatin e dëshiruar nga punonjësi kërkimor-shkencor;

iv. mosrespektimi i 1 deri në 2 parimeve dhe i standardeve themelore, në zbatim të parimit të shkencës së hapur;

v. manipulimi i 1 deri në 2 të dhënave të veprimtarisë kërkimore-shkencore, në prezantimin e një rezultati të rremë;

vi. abuzimi me burimet financiare, kur shkaktohet dëm ekonomik, deri në masën 15% të buxhetit total të projektit;

c)shkelje shumë të rënda, që konsiderohen:

i. plagjiatura e përsëritur e evidentuar, sipas kriterëve në legjislacioni në fuqi;

ii. mosrespektimi i çdo kriteri dhe standardi, që mundësojnë zbatimin e parimit të shkencës së hapur në Republikën e Shqipërisë;

iii. mosrespektimi i çdo parimi të Kodit të Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor, sipas legjislacionit në fuqi;

iv. tjetërsimi i dokumentacionit, metodologjisë, të dhënave të kërkimit-shkencor në rezultatet përfundimtare, të veprimtarisë kërkimore-shkencore, duke prezantuar një rezultat të rremë.

Neni 31

Masat disiplinore

1. Masat disiplinore propozohen nga Këshilli i Etikës dhe jepen nga titullari i institutit apo njësisë së veçantë të kërkimit shkencor.

2. Masat disiplinore jepen në varësi të llojeve të shkeljeve të Kodit të Etikës në Shkencë dhe në Kërkimin Shkencor dhe klasifikohen, si më poshtë vijon:

a) Për shkelje të lehta, si vijon:

i. “Vërejtje me shkrim”, jepet për manipulimin e produktit autorial, të paktën në një rast;

ii. “Vërejtje me shkrim dhe trajnim për zbatimin e kodit të etikës në kërkimin shkencor”, jepet për mosdeklarimi i drejtpërdrejtë i faktit të një konflikti interesi të drejtpërdrejtë ose të mundshëm përgjatë procesit kërkimor-shkencor;

iii. “Vërejtje me shkrim dhe reduktim i pagës me 30%”, jepet për mosdeklarimin e një konflikti interesi të drejtpërdrejtë ose të mundshëm përgjatë procesit kërkimor-shkencor;

b) Shkelje të rënda janë, si vijon:

i. "Reduktim i pagës nga 30% deri në 70% përgjatë zhvillimit të projektit shkencor", jepet për plagjiaturë, e konstatuar sipas kritereve në legjislacionin në fuqi;

ii. "Vërejtje me shkrim për përjashtim nga projektet kërkimore-shkencore", jepet për kompromentimi i etapave të ndryshme të veprimtarisë së kërkimit shkencor;

iii. "Paralajmërim për ndërprerjen e kërkimit shkencor", jepet për:

- 1) manipulimi i tërthortë ose i plotë i rezultateve, dokumentacioneve, metodologjive, të dhënave, që mundësojnë rezultatin e dëshiruar nga punonjësi kërkimor-shkencor;
- 2) mosrespektimi i 1 deri në 2 parimeve dhe i standardeve themelore, në zbatim të parimit të shkencës së hapur;
- 3) manipulimi i 1 deri në 2 të dhënave të veprimtarisë kërkimore-shkencore, në prezantimin e një rezultati të rremë;
- 4) abuzimi me burimet financiare, kur shkaktohet dëm ekonomik, deri në masën 15% të buxhetit total të projektit;

c) Shkelje shumë të rënda janë, si vijon:

i. "Transferimi i kërkimit shkencor një kërkuesi tjetër shkencor", jepet për plagjiaturën e përsëritur të evidentuar, sipas kritereve në legjislacionin në fuqi;

ii. "Revokimi, shkurtrimi ose ndërprerja, rimbursimi i fondeve të kërkimit shkencor", jepet për mosrespektimin e çdo kriteri dhe standardi, që mundëson zbatimin e parimit të shkencës së hapur në Republikën e Shqipërisë;

iii. "Përjashtimi përkohësisht për të marrë pjesë në aktivitete dhe kërkime shkencore", jepet për mosrespektimin e çdo parimi të Kodit të Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor, sipas legjislacionit në fuqi;

iv. "Shfuqizimi i kategorisë së punonjësit të kërkimit shkencor", jepet për tjetërsimin e dokumentacionit, metodologjisë, të dhënave të kërkimit-shkencor në rezultatet përfundimtare, të veprimtarisë kërkimore-shkencore, duke prezantuar një rezultat të rremë.

3. Masat disiplinore parashkruhen sipas kalimit të këtyre afateve për:

a) shkelje të lehta, brenda 3 viteve;

b) shkelje të rënda, brenda 4 viteve;

c) shkelje shumë të rënda, brenda 5 viteve.

4. Masa disiplinore më e rëndë është shfuqizimi i kategorisë së punonjësit të kërkimit shkencor, e cila jepet vetëm për shkelje të rënda të etikës së kërkimit shkencor.

5. Parimi i ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë duhet të zbatohet gjatë përcaktimit të masës disiplinore, që propozohet nga Këshilli i Etikës.

6. Propozimi i dhënies së masës disiplinore përkatëse jepet në varësi të llojit, masës dhe dëmit të shkaktuar nga kryerja e shkeljes.

Neni 32

Dispozita Përfundimtare

1. Çdo dispozitë, vendim apo akt tjetër i mëparshëm i miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Sporteve të Tiranës, i cili bie në kundërshtim me këtë Rregullore, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të saj.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe bëhet pjesë përbërëse e akteve rregullatore të institucionit.



UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

**RREGULLORJA E ORGANIZIMIT DHE
FUNKSIONIMIT
TË KËSHILLIT TË ETIKËS**

Miratuar me Vendimin e Senatit Akademik Nr. 19, datë 23.02.2026

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Etikës në Universitetin e Sporteve të Tiranës, në përputhje me misionin e institucionit, objektivat, detyrimet dhe kuadrin ligjor në fuqi.
2. Rregullorja përcakton gjithashtu dispozita të detajuara procedurale që rregullojnë ushtrimin e kompetencave të këtij Këshilli.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo rregullore është hartuar në zbatim të:

- Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;
- Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe të enteve publike”;
- Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës;
- Rregullores së Universitetit të Sporteve të Tiranës;
- Kodit të Etikës së Universitetit të Sporteve të Tiranës.

Neni 3

Parimet e Veprimtarisë

Këshilli i Etikës e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimet e:

- ligjshmërisë,
- transparencës,
- informimit,
- proporcionalitetit,
- drejtësisë dhe paanësisë,
- objektivitetit,
- mosdiskriminimit,
- mbrojtjes së konfidencialitetit dhe të dhënave personale.

Neni 4

Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës është një organ kolegjal i Universitetit të Sporteve të Tiranës. Organizimi dhe funksionimi i tij rregullohet nga kjo rregullore, në përputhje me Statutin e Universitetit dhe aktet e tij të brendshme.
2. Në rast se Këshilli i Etikës vihet në dijeni të një shkeljeje të mundshme të Kodit të Etikës, ai ka të drejtë të verifikojë burimin dhe saktësinë e informacionit dhe të kërkojë, me iniciativën e vet, informacione të nevojshme nga personeli akademik, studentët, personeli ndihës akademik dhe administrativ, si dhe nga njësitë përbërëse të Universitetit të Sporteve të Tiranës.

Neni 5

Pavarësia dhe Paanësia e Këshillit të Etikës

1. Këshilli i Etikës ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë të pavarur nga çdo strukturë tjetër e Universitetit të Sporteve të Tiranës, duke garantuar paanësinë institucionale dhe profesionale në shqyrtimin e çështjeve që lidhen me zbatimin e Kodit të Etikës.
2. Anëtarët e Këshillit të Etikës janë të detyruar të shmangin çdo situatë që mund të paraqesë konflikt interesi në shqyrtimin e një rasti të caktuar dhe duhet të deklarojnë paraprakisht çdo lidhje të mundshme personale, akademike apo profesionale me subjektin ose palët e përfshira.
3. Në rast të verifikimit të një konflikti interesi, anëtari në fjalë përjashtohet përkohësisht nga procedura, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
4. Këshilli garanton mbrojtjen e konfidencialitetit të informacionit të trajtuar, si dhe integritetin moral dhe profesional të individëve të përfshirë në procedurat e shqyrtimit.
5. Asnjë anëtar i Këshillit nuk mund të ushtrojë presion, ndikim apo të përfshihet në veprime që mund të çenojnë objektivitetin dhe integritetin e vendimmarrjes.

Neni 6

Përbërja e Këshillit të Etikës

1. Këshilli i Etikës përbëhet nga anëtarë me integritet të lartë profesional dhe moral, të cilët përfaqësojnë në mënyrë të balancuar njësitë përbërëse të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
2. Këshilli i Etikës përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë:

- a) nga një anëtar për çdo njësi kryesore, që janë personel akademik me kohë të plotë, ata i përkasin kategorisë “Profesor” ose “Lektor”;
 - b) një anëtar përfaqësues i studentëve;
 - c) një përfaqësues nga personeli administrativ;
 - d) një përfaqësues nga personeli ndihmës-akademik;
3. Anëtarët e Këshillit zgjidhen nga Senati Akademik, mbi bazën e listës përfundimtare të kandidaturave që i përcillen Senatit për miratim nga Rektori, sipas propozimeve të njëjësive përbërëse të UST-së.
 4. Përbërja e Këshillit duhet të garantojë përfaqësim të njëjësive akademike, përvojë të provuar në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe etikë profesionale, në përputhje me Statutin e UST-së.
 5. Mandati i anëtarëve të Këshillit është 4 (katër) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
 6. Këshilli ka në përbërje një Kryetar, i cili zgjidhet me shumicë votash nga vetë anëtarët e Këshillit në mbledhjen e parë konstituive.
 7. Në rast të dorëheqjes, largimit apo pamundësisë për ushtrimin e detyrës nga një anëtar i Këshillit, Senati Akademik vendos për zëvendësimin e tij brenda një afati jo më të gjatë se 30 (tridhjetë) ditë nga njoftimi i ngjarjes përkatëse.

Neni 7

Përfundimi i mandatit të anëtarëve të komisioneve dhe të Këshillit të Etikës

Mandati i anëtarëve të Këshillit të Etikës përfundon:

- a) me mbarimin e afatit;
- b) me dorëheqje;
- c) kur ndërpret marrëdhëniet financiare me UST-në;
- d) kur mungon pa arsye në 3 (tre) mbledhje rradhazi;
- e) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- f) në rastet e pamundësisë për të kryer detyrën;
- g) në rastet e shkeljeve të rënda të ligjit;

Neni 8

Mënyra e Organizimit të Këshillit të Etikës dhe Shpërblimi

1. Këshilli i Etikës zhvillon mbledhjet e tij periodike jo më rrallë se një herë në tre muaj dhe, sipas nevojës, në raste të veçanta kur paraqiten ankesa apo kërkesa për shqyrtim nga njësitë përbërëse të Universitetit apo individë të interesuar.
2. Mbledhjet thirren nga Kryetari i Këshillit ose me kërkesë të shumicës së anëtarëve. Thirrja e mbledhjes duhet të shoqërohet me rendin e ditës dhe materialet përkatëse të shqyrtimit.

3. Këshilli është në kuorum të vlefshëm kur marrin pjesë të paktën 4 (katër) nga 7 (shtatë) anëtarët, përfshirë Kryetarin.
4. Procesverbalet e mbledhjeve hartohen dhe ruhen në mënyrë të dokumentuar nga koordinatori i Këshillit të Etikës, i cili është anëtar i Këshillit të Etikës.
5. Anëtarët e Këshillit të Etikës përfitojnë shpërblim financiar për angazhimin e tyre në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe vendimet e organeve drejtuese të Universitetit.

Neni 9

Kryetari i Këshillit të Etikës

1. Kryetari i Këshillit të Etikës zgjidhet nga vetë anëtarët e Këshillit në mbledhjen e parë konstitutive, brenda një jave nga zgjedhja e tij nga Senati, përmes votimit të hapur dhe me shumicë të thjeshtë votash.
2. Kryetari ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - a) Thërret dhe drejton mbledhjet e Këshillit të Etikës;
 - b) Përfaqëson Këshillin në marrëdhënie me organet e tjera të Universitetit dhe jashtë tij;
 - c) Siguron zbatimin e Rregullores dhe Kodit të Etikës në procedurat e shqyrtimit;
 - d) Ndjek zbatimin e vendimeve të Këshillit dhe njofton autoritetet kompetente për rezultatet përfundimtare;
 - e) Mbikëqyr veprimtarinë administrative dhe teknike që lidhet me punën e Këshillit.
3. Në mungesë të Kryetarit, detyrat e tij ushtrohen nga një anëtar i deleguar prej tij. Në pamundësi të delegimit, caktohet përkohësisht anëtar i me përvojën më të gjatë si anëtar i Këshillit.

Neni 10

Kompetencat e Këshillit të Etikës

1. Këshilli i Etikës promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale.
2. Këshilli i Etikës ka për detyrë:
 - a) të shqyrtojë të gjitha rastet që lidhen me shkelje të Kodit të Etikës, të paraqitura me anë të kërkesave, ankesave apo informacioneve zyrtare;
 - b) të kryejë një hetim të plotë administrativ duke verifikuar faktet dhe rrethanat përkatëse, duke mbledhur informacion të plotë dhe të paanshëm;
 - c) të dëgjojë palët e përfshira dhe të sigurojë një proces të drejtë dhe transparent;
 - d) të japë mendime ose rekomandime për masat që duhen ndërmarrë në rastet e konstatimit të shkeljeve etike;

- e) të bashkëpunojë me njësitë e tjera të Universitetit në funksion të promovimit të kulturës etike dhe parandalimit të shkeljeve;
 - f) të sugjerojë përmirësime për Kodin e Etikës dhe standardet etike në institucion.
3. Këshilli mund të propozojë masa disiplinore tek organet përgjegjëse akademike, në përputhje me Statutin dhe rregulloret përkatëse të Universitetit.
 4. Këshilli ushtron funksione disiplinore ndaj studentëve të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
 5. Këshilli mund të ndërmarrë veprimtari sensibilizuese, si seminare, trajnime ose botime, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e etikës në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

Neni 11

Thirrja dhe Zhvillimi i Mbledhjeve

1. Këshilli i Etikës zhvillon mbledhje të rregullta jo më rrallë se një herë në tre muaj.
2. Mbledhjet thirren nga Kryetari i Këshillit me njoftim të dërguar të paktën 2 (dy) ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes, duke përcaktuar rendin e ditës dhe materialet që do të shqyrtohen.
3. Në raste të jashtëzakonshme, mbledhjet mund të thirren urgjentisht me kërkesë të Kryetarit ose të paktën 4 (katër) anëtarëve të Këshillit.
4. Mbledhjet zhvillohen me praninë fizike të anëtarëve ose, kur është e nevojshme, përmes mjeteve të komunikimit elektronik, duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe integritetit të diskutimeve.
5. Procesverbalet e mbledhjeve hartohen nga koordinatori, nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e pranishëm të Këshillit dhe ruhen në arkivën zyrtare të Universitetit.
6. Vendimet e Këshillit të Etikës nënshkruhen nga Kryetari i Këshillit të Etikës.

Neni 12

Kuorumi dhe Marrja e Vendimeve në Këshillin e Etikës

1. Këshilli i Etikës mund të zhvillojë mbledhje dhe të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm të paktën 4 (katër) nga 7 (shtatë) anëtarët, përfshirë Kryetarin.
2. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm.
3. Në rast barazie votash, vota e Kryetarit është vendimtare.
4. Vendimet për rastet që lidhen me shkelje të rënda të Kodit të Etikës duhet të jenë të argumentuara dhe të dokumentuara në mënyrë të plotë.
5. Çdo vendim i Këshillit zbardhet dhe i njoftohet autoriteteve përkatëse brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh pune nga data e miratimit.

Neni 13

Pranimi i Shqyrtimit të Kërkesës apo Ankesës

1. Këshilli i Etikës vendos të fillojë shqyrtimin e një kërkesë apo ankese të drejtuar ndaj tij brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike nga data e regjistrimit të saj në protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës.
2. Kryetari i Këshillit është përgjegjës për informimin e anëtarëve të Këshillit mbi paraqitjen e kërkesës apo ankesës, si dhe për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për shqyrtim.
3. Këshilli, në mbledhjen e parë pas mbërritjes së kërkesës, vendos për:
 - o Pranimin për shqyrtim të kërkesës apo ankesës;
 - o Refuzimin e saj për mungesë kompetence ose për arsye procedurale të qarta;
 - o Kërkimin e informacionit shtesë për plotësimin e dokumentacionit përkatës.
4. Palët e përfshira në kërkesë ose ankese njoftohen me shkrim për vendimin e marrë dhe, kur është rasti, për afatet dhe format e mëtejshme të trajtimit.

Neni 14

Dhënia e Ndhmës Aktive nga Këshilli i Etikës

1. Subjektet e procedurës (ankuesi dhe pala ndaj të cilës drejtohet ankesa) njoftohen me shkrim mbi marrjen ose jo në shqyrtim të çështjes.
2. Mbledhja për shqyrtimin e një kërkesë ose ankese zhvillohet jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e marrjes në administrim të saj nga sekretaria përkatëse.
3. Gjatë zhvillimit të procedurës, Këshilli i Etikës ofron ndihmë aktive për palët, duke sqaruar procedurën, të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe duke garantuar një mjedis të drejtë dhe pa presion për paraqitjen e argumenteve apo provave.
4. Këshilli mund të vendosë, kur e shih të arsyeshme, të ftojë dëshmitarë, ekspertë apo përfaqësues të strukturave të tjera për dhënie informacioni.

Neni 15

Përpjekjet për Zgjidhjen me Pajtim dhe Konsensus

1. Përpara marrjes së një vendimi përfundimtar, në varësi të çështjes, Këshilli i Etikës synon të lehtësojë një proces pajtimi midis palëve, përmes ndërmjetësimit dhe dialogut konstruktiv.
2. Këshilli mund të propozojë zgjidhje alternative, duke respektuar parimet e Kodit të Etikës dhe interesat legjitime të palëve të përfshira.
3. Nëse arrihet pajtimi ose zgjidhja konsensuale, kjo pasqyrohet në një vendim të dokumentuar të Këshillit, i cili i dërgohet palëve dhe arkivohet në Universitet.
4. Zgjidhja me pajtueshmëri nuk pengon të drejtën e palëve për t'iu drejtuar organeve të tjera administrative ose gjyqësore, nëse e konsiderojnë të nevojshme.

Neni 16

Seanca për Shqyrtimin e Kërkesës ose Ankesës

1. Këshilli i Etikës siguron trajtimin e drejtë dhe të paanshëm të çështjes, duke u bazuar në prova, dëshmi dhe rrethana të qarta dhe të verifikueshme.
2. Seanca mund të zhvillohet në një ose më shumë mbledhje, në varësi të kompleksitetit të rastit dhe nevojës për mbledhje të mëtejshme të informacionit.
3. Përpara se të merret vendimi përfundimtar nga Këshilli i Etikës, përveç rasteve të nenit 64 të KPA-së, njoftohen palët lidhur me të drejtën e tyre për tu dëgjuar.
4. Palët e përfshira, kanë të drejtë të paraqesin qëndrimet e tyre, dokumente mbështetëse dhe të kërkojnë informacion.
5. Palët mund të përfaqësohen në seancë nga persona të autorizuar me prokurë. Në pamundësi të pjesëmarrjes fizike të palëve seanca dëgjimore mund të zhvillohet përmes mjeteve të komunikimit elektronik.
6. Shqyrtimi i çështjes zhvillohet me dyer të mbyllura, duke respektuar parimin e konfidencialitetit, integritetin e diskutimeve dhe dinjitetin e palëve të përfshira.
7. Çdo formë presioni, intimidimi apo fyerjeje ndalohet reptësisht.

Neni 17

Konstatimi i Shkeljes dhe Përfundimi i Procedurës nga Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës, pas përfundimit të shqyrtimit të plotë të kërkesës apo ankesës, vlerëson nëse subjekti i procedurës ka kryer ndonjë nga shkeljet e parashikuara në legjislacionin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, Aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, Statutin, këtë Rregullore, Kodin e Etikës dhe rregulloret apo aktet e tjera të Universitetit të Sporteve të Tiranës në momentin e ndodhjes së veprimit ose mosveprimit që përbën shkelje.
2. Këshilli i Etikës, pasi përfundon shqyrtimin e çështjes, i paraqet Senatit Akademik brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh pune vendimin e tij, së bashku me dosjen e plotë të shqyrtimit.
3. Vendimi përfundimtar i Këshillit, i cili shoqërohet me relacionin përkatës, duhet të përmbajë:
 - a. Emrat dhe mbiemrat e anëtarëve të Këshillit që kanë marrë pjesë në vendimmarrje;
 - b. Gjeneralitetet e subjektit të procedurës;
 - c. Përshkrimin e shkeljeve faktike të konstatuara gjatë shqyrtimit;
 - d. Masën e rekomanduar dhe bazën ligjore apo nënligjore (dispozitën konkrete) ku mbështetet kjo masë;
 - e. Të drejtën e subjektit të procedurës për të paraqitur ankesë apo apel, si dhe afatet dhe organin përkatës ku mund të bëhet ankimi;
 - f. Nënshkrimin e Kryetarit të Këshillit të Etikës.
4. Vendimi i Këshillit i dërgohet me shkrim palëve të interesuara dhe regjistrohet në protokollin zyrtar të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
5. Vendimi i Këshillit që përmban konstatime apo rekomandime, i dërgohet Rektorit.

6. Vendimi i Këshillit i Etikës është këshillues dhe shoqërohet me propozim për masa disiplinore për stafin akademik.
7. Vendimi i Këshillit i Etikës është përfundimtar për dhënien e masës disiplinore për studentët.

Neni 18 **Ankimimi**

1. Vendimi përfundimtar për dhënien e masës disiplinore nga Këshilli i Etikës ndaj studentëve, mund të ankimohet në gjykatë brenda afatit 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e marrjes dijeni të vendimit, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë.
2. Vendimi për propozimin e dhënies së masës disiplinore ndaj stafit akademik shqyrtohet nga Komisioni ad hoc i ngritur pranë Senatit Akademik, në mënyrë të pavarur, objektive dhe të paanshme, bazuar në dokumentacionin e dosjes dhe çdo prove të paraqitur nga palët.
3. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni ad hoc merr një nga vendimet e mëposhtme:
 - a. Lë në fuqi vendimin e Këshillit të Etikës;
 - b. E ndryshon pjesërisht vendimin, duke riformuluar masën ose arsyetimin;
 - c. E shfuqizon vendimin dhe vendos pushimin e procedurës.
4. Vendimi i Komisionit ad hoc është i formës së prerë në kuadër të institucionit dhe u komunikohet palëve të interesuara brenda 5(pesë) ditëve pune nga miratimi.
5. Vendimi i Komisionit ad hoc mund të ankimohet në gjykatën kompetente brenda afatit 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e marrjes dijeni të vendimit, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Neni 19 **Dispozita Përfundimtare**

1. Çdo dispozitë, vendim apo akt tjetër i mëparshëm i miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Sporteve të Tiranës, i cili bie në kundërshtim me këtë Rregullore, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të saj.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe bëhet pjesë përbërëse e akteve rregullatore të institucionit.